



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:216673

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06258871

PPP.nr.35/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditores së përmbarimit Gj me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit F.H.B nga fshati Nushpall, Komuna Rahovec, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,622.70 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm, lejuar me urdhrin për përmbarim, P.nr.470/23 të datës 31.08.2023, të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës më datën 07.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht i bazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit F.H.B nga fshati Nushpall, Komuna Rahovec, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.470/23 të datës 31.08.2023, të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, për një pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 972.40 euro, nga detyrimi total në shumën e kërkuar prej 1,622.70 euro.

II. SHFUQIZOHET pjesërisht i njëjti urdhër për përmbarim për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 972.40 euro.

III. REFUZHET pjesërisht i pabazuar propozimi për përmbarim i kreditores së përmbarimit, Gj me seli në Gjakovë, që pala debitorë të obligohet të paguaj një pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 972.40 euro.

IV. REFUZHET pjesërisht i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit F.H.B nga fshati Nushpall, Komuna Rahovec, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.470/23 të datës 31.08.2023, të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, për një pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 650.30 euro, nga detyrimi total në shumën e kërkuar prej 1,622.70 euro.

VI. MBETET pjesërisht në fuqi i njëjti urdhër për përmbarim, për këtë pjesë të detyrimit në të holla në shumën prej 650.30 euro.

VII. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat Gj.R nga Gjakova, me urdhrin për përmbarim, P.nr.470/23 të datës 31.08.2023, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditores së përmbarimit, Gj me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit F.H.B nga fshati Nushpall, Komuna Rahovec, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,622.70 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm.

Kundër këtij urdhri për përmbarim, pas pranimit të tij, debitori ka ushtruar prapësim, më gjerësisht si në arsyetimin e këtij prapësimi, ndërsa pas pranimit të prapësimit nga pala kreditore, ka parashtruar përgjigje në prapësim, më gjerësisht si në përgjigjen në prapësim.

Sa i përket dokumentit përmbarimor, gjykata erdhi në përfundim se kreditorja e përmbarimit, propozimin për përmbarim e ka bërë sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,622.70 euro, në emër të shpenzimeve për furnizim me ujë të pijshëm. Pra, dokumenti mbi të cilin pala kreditore e mbështet propozimin për përmbarim përbën dokument të besueshëm, në përputhje me nenin 29 par. 1 nën par. 2 të LPP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore shprehimisht theksohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në propozimin për përmbarim të datës 31.08.2023, të lejuar nga përmbaruesi privat Gj.R në Gjakovë me urdhrin P.nr.470/23 të datës 31.08.2023, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 01.07.2018 deri me datë 01.08.2023.

Sa i përket borxhit për periudhën prej datës 01.07.2018 e deri më datën 31.12.2021, gjykata gjeti se për këtë periudhë kohore për borxhin në shumën prej 972.40 euro ka arritur parashkrimi sepse në nenin 360 par.1 të LMD-së parashihet që *“1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa kreditori propozimin për përmbarim e ka parashtruar më datë 31.08.2023.

Pagesat e kohëpaskohshme në lartësi të ndryshme të bëra nga debitori nuk mund të llogaritet si pranimit i borxhit dhe të njëjtat nuk e kanë ndërprerë parashkrimin siç pretendon kreditori. Në nenin 368 par. 2 të LMD-së përcaktohet: *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa*

e kamatës, dhënia e sigurimit". Në rastin konkret pagesa e debitorit nuk hynë në kategorinë e pagesave të kësteve, pasi që kësti konsiderohet ndarja e borxhit në periudha të caktuara mujore apo më gjatë, ku borxhi i përgjithshëm ndahet në pjesë më të vogla për pagesë për periudhë të caktuar. Po ashtu kësti do të mund të llogaritej nëse do të ekzistonte një marrëveshje në mes kreditorit dhe debitorit, qoftë për ri programim të borxhit apo për pagesë të borxhit total të ndarë në këste, ndërsa kjo nuk i atribuohet pagesave të debitorit, sepse edhe pse kemi borxh të akumuluar nga faturat mujore nuk kemi marrëveshje për ndarje me këste në mes të palëve dhe pa një marrëveshje të tillë pagesat nuk trajtohen këste. Pagesa të kryera kohe pas kohe nga ana debitorit janë pagesa në shuma të ndryshme paushallë dhe jo pagesa në emër të faturave mujore në shumë siç janë përcaktuar në faturë, andaj këto pagesat të kohëpaskohshme në shuma të ndryshme nuk konsiderohen si pranim i borxhit nga ana e debitorit, andaj të njëjtat nuk e kanë shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit.

Ndërsa sa i përket periudhës kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 01.08.2023, gjykata vlerëson se për këtë periudhë është ndërprerë parashkrimi dhe atë për shumën e përgjithshme prej 659.49 euro, ku gjykata sa i përket përfshirjes së vitit paraprak ka vepruar sipas nenit 360 par.2 të LMD-së, sipas të cilit *"Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë"*. Meqenëse kreditorja ka ushtruar propozim për përmbarim me datën 31.08.2023, i njëjti e ka ndalur parashkrimin e borxhit për një (1) vit në mënyrë retroaktive. Gjykata nga kartela e konsumatorit gjeti se debitori për periudhën nga 01.01.2022 e deri më datën 01.08.2023 ka krijuar borxh në vlerën prej 650.30 euro, për të cilin gjykata vendosi ta lërë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat sepse nuk ka kaluar afati caktuar me ligj në kohëzgjatje prej një (1) viti, ashtu që nuk ka parashkrim për këtë periudhë kohore konform nenit 369 të LMD-se, i cili përcakton se: *"Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës"*.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *"Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit"*.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 5, 21, 29, 37, 40, 69, 71, 73, 77 dhe nenit 78 të LPP-së lidhur me nenin 9 dhe 12 të Ligjit nr. 05/L-118 të datës 18.04.2018 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.04/L-139 të datës 20.12.2012 të LPP-së si dhe lidhur me nenin 65 dhe 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 04/L-077.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.35/2023 më datë 07.10.2024

Numri i lëndës: 2023:216673
Datë: 07.10.2024
Numri i dokumentit: 06258871

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.